



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-47186

Pejë, datë: 28 Qeshor 2024

### PROCESVERBAL

Nga takimi i –VI- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **28 qeshor 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina, asistente e kryesuesit, znj.Florinda Berisha: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hap diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoi se janë 32 anëtarë prezent. Po ashtu deklaroi se votimi duhet të bëhet me ngritje dore për shkak të problemeve teknike.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

#### REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalve të Kuvendit të Komunës së Pejës (seancës së jashtëzakonshme dt. 16.04.2024, seancës së dt. 26.04.2024 dhe seancës së dt. 28.05.2024).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.
6. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

7. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
9. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

#### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.**

Në takim munguan znj.Hidajete Krasniqi dhe z.Shqiprim Muriqi.

#### **2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.**

Nuk ka pasur.

#### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalve të Kuvendit të Komunës së Pejës (seancës së jashtëzakonshme dt. 16.04.2024, seancës së dt. 26.04.2024 dhe seancës së dt. 28.05.2024).**

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, me vërejtjet që u dhanë miratohen procesverbalet (seancës së jashtëzakonshme dt. 16.04.2024, seancës së dt. 26.04.2024 dhe seancës së dt. 28.05.2024).

#### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** është një dokument që është shqyrtu edhe në takimin e KPF-së, gjithashtu nga grupi i caktum nga kryetari i komunës për hartimin e këtij dokumenti. Gjithashtu, edhe diskutimi publik që është mbajt për kornizen afatmesme buxhetore, tani e kemi draftin final të gatshëm

**Znj. Xhevahire Çeku Kelmendi:** une, si në KPF aty nuk e kam votu dhe prap vazhdoj me mbajt të njejtin qendrim. Si arsye mos rregullimi i pllatosë në memorialin e dëshmorëve në Karagaq. Mendoj që është zgjat shumë kjo çështje, dhe po mendoj që edhe arsytimeve të shumëta i ka hup kuptimi!

**Z.Islam Husaj:** më ra në sy mungesë e planifikimit të mjeteve për pagesen e komiteteve të kuvendit. Nuk ka mjete të planifikume, dhe nëse nuk planifikohen nuk mundën edhe me u pagu në asnjë menyrë. Mirë është me qenë të planifikuara, dhe pastaj me pa mundësinë e pagesave të këtyre komiteteve. Janë trupa të kuvendit dhe me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale jemi mundu me i themelu, por me vendime të kuvendit mund edhe të bëhet pagesa e tyre, por nuk mund të bëhen nëse nuk planifikohen paraprakishtë! Prandaj, unë propozoj që një planifikim i tillë të bëhet, në menyrë që kur e aprovojmë buxhetin, të jenë pjesë e buxhetit.

**Z.Naim Bytyqi:** sa i përket kornizes afatmesme buxhetore 2025-2027, çështja e cila dua të bisedoj sot, është arsyeja e disa projekteve të cilat po i shohim në këtë kornizë. Krahasuar me kornizen e vitit të kaluar, ky dokument e dijmë të gjithë që mund të ketë levizje dhe mund të ketë ndryshme. Mirëpo, një sqarim të cilin po kërkoj sot është cilat janë arsyet a mund të na thotë dikush për shtyrjen, heqjen e disa projekteve? Prap po e përseris nëse e marim kornizen buxhetore

të vitit e kaluar, shuma e përgjithëshme është 13 milionë e gjysë përafersisht për vitin 2025, sa % të ketyra mjeteve do të shkojnë për investime të reja, dhe sa % të ketyra mjeteve do të paguhet borgjet? Të cilat janë bartë nga viti në vit, dhe kjo e determinon se a do të kemi investime të reja dhe a do të ndryshoj jeta e qytetarëve? Sepse nga këto investime përcaktohet. Arësyeja pse disa projekte janë hequr, dhe përse disa janë shtyer duke marrë parasysh kornizën e vitit të kaluar? Siq janë QMF-ja në fsh Radavc, shtëpia për komunitet për persona me aftësi të kufizura, ndërtimi i palestres basketbollit në lagjen Karagaq, ndërtimi i sheshit Shkelzen Haradinaj-Haxhi Zeka, heqja e mjeteve për ashensor, ndërtimi i palestres sportit në fsh .Kryshec, ndërtimi i palestres në fsh Llozhan, shtyerja e ndërtimit të palestres në fsh. Qyshk. Këto janë pyetjet për të cilat deshiroj me marrë përgjigje, sespe me takon me marrë përgjigje, sepse ka 2 vjet e gjysë që merem me këto probleme dhe po vazhdojnë, edhe raporti i auditimit ato se qfare i kemi folur gjatë ketyre viteve , qato të gjetura i ka gjet edhe auditori dhe po besoj që në ditët në vijim do të vjen edhe raporti i auditimit!

**Z.Berat Ganiqi:** sot, me gjithë dëshirë kisha dasht këtu me pa drejtoreshën e re të financave por po duket që po refuzon me ardh, kishte me qenë mirë qe me qenë ktu dhe ma na sqaru pak ma shumë KAB-in. Por këtu nuk qenka as drejtortësia dhe as zyrtarja e kryesore financiare! Andaj, për mua janë disa pyetje të paqarta thotë: ndërtimi i sheshit prej ures zallit deri te? Deri ku? Deri te xhamia e Kuqe a , deri te Rrokaqielli a? Parashihen deri në vitin 2026 ,500 mijë dhe 2027, 500 mijë, 1 milionë sqarimi deri ku? Projektet e zhvillimit ekonomik sipas KAB-it të ri 2025,2026,2027 janë parapa për secilin vit kah 200 mijë euro, ndërsa sipas KAB-it 2024, 2026 ndërsa për vitin 2025 dhe vitin 2026 janë parpa kah 300 mijë euro, dmth jemi minus 200 mijë euro te zhvillimi ekonomik! Po ashtu te projektet e zhvillimit ekonomik nuk tregohen se cilat projekte cilat janë ato dhe çka ka me bo, me dit se a kemi ndonjë plan a po vetëm projektet e zhvillimit ekonomik? Ujësjiellësi në Lugun e Baranit nuk po e shoh kerkund, ose ka përfunduar e spo e di unë ose e keni hek prej listes! Turizmi i aventures në komunën e Pejës për vitin 2025 janë nda 57 mijë e 210 euro, nuk tregohet çka? Çfarë turizmi me 57 mijë e 210 euro me bo turizem a, që është burimi kryesor ? Buxheti për palestren në Qyshk ka qenë në KAB-in 2024-2026, nuk e kam pa në KAB-in 2025-2027. Ndërtimi i qerdhes në Zahaq parashihet me ndodh në vitin 2027 sipas ketij KAB-it, ndërsa unë po bëj qudi se si injorohen thirrjet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkences! Meqenëse ata kanë bo thirrje me përkrah projektin e ndërtimit të qerdhes. Në turizem thuhet se kemi marr pjesë në takim në kontratën Swis Kontakt së bashku me asocianonet e komunave, po më intereson a keni ndonjë projekt me Swis Contact? Sepse komuna e Prizrenit e ka një projekt shumë të madhor ndërtimin e teleferikut. Pastaj desha të ndalem në shumë projekte që janë të parapame, pa dasht me bo ndarje gjeografike miërpo 90% të projekteve janë të koncentruara në zona rurale, ndërsa në qytet se di a janë 10%! Qyteti, është shumë keq po shihen edhe rrugët edhe ketë gjelbrim qe ka mbet kemi fillu me shkatru, edhe për gjelberim që është nda buxhet në KAB-in e ri nuk po e shoh. Këto ishin pyetjen e mija dhe kishte me qenë mirë me u sqaru ndërtimi i sheshit deri ku, sespe nuk është e shkrume!

**Z.Rajan Arapi:** unë nuk isha ndal tek shumë pika, përpos tek sheshi “Shkelzen Haradinaj” dhe “Haxhi Zeka”, është një projekt i cili në PZHK nëse i përmbahemi ketij plani sepse shpesh thirremi në të dhe nuk i përmbahemi. Sidomos në aspektin e periudhave kohore, thuhet se do të fillon në vitin 2026 dhe do të përfundoj në vitin 2027. Kryetar, plani zhvillimor komunal e thotë ndryshe pak më heret ndëtimi i ketij sheshit, megjithëatë kishte me qenë mirë të shpjegohet se çfarë do të ndodhë tash dhe si do të ndërtohet? Sespe ne e dijme që ajo rrugë do të bllokohet për qarkullim na jepni disa shpjegime. Përndryshe tek ky shesh është edhe ai projekti i famshëm, që 3,4 vite e permendi mbulojen e Shtëpisë së Mallrave që nuk është i planifikum në këtë kornizë afatmesem buxhetore, pse nuk është planifiku, a do të kryhet kjo mbulojë deri sa të ndërtohet sheshi? Nëse po, kishte me qenë mirë me tregu sepse nëse nuk ndërtohet deri në vitin 2027 atëhere nuk është mirë! Po ashtu edhe unë kisha me thënë që drejtoresha për buxhet dhe financa kishte me qenë mirë me qenë prezent, sepse me qenë drejtoreshë nuk është vetëm privilegj por edhe përgjegjësi. Përgjegjësia mbahet edhe në zyre edhe para asambleisteve të cilet kanë kërkesa, normalisht edhe ne kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve sepse kto kërkesa dhe këto pyetje duhet ti marim përgjigje adekuate prej personave përgjegjës.

**Z.Feriz Gashi:** po të krahasohen dy kornizat e fundit ajo e vitit të kaluar dhe kjo tani, shihet se ka shumë shtyre, levizje, bartje mjeteve etj. Janë tri çështje që desha me i parashtrur ndoshta kryetari ka përgjigje! I kishit parapa 400 mijë euro investime për ndërtimin e gjimnazit “Bedri Pejani”, përveç të rrënimt të atyre themeleve dhe një grumbull dhe aty nuk shihet diçka tjetër! Pastaj çështja tjetër që e permendi Naimi dhe Berati në kornizen e viti të kaluar 200 mijë euro investime për ndërtimin e palestres në Qyshk, ndërsa në këte kornizë janë 0 euro investime, pse 0 investime? Po ashtu e kishit bërë shtyrjen e mjeteve të ndërtimit të QMF –së në fsh Radave! Në bisede me disa banor ata kanë dyshime nëse kjo qender do të bëhet, edhe në një farë menyre është e vërtet që kjo qender do të bëhet atje?

**Znj.Eleonora Bala:** meqenëse unë vi nga lamia e mjekësisë, më interesojnë disa çështje në lidhje me shërbimet primare shëndetësore, aty edhe ku punoj! Në radhë të parë është qendra e mjekësisë multifunktionale të trajnimeve faza e dytë në lagjen 2 Korriku të ndara 250 mijë euro, po me intereson kjo qender sepse një qender trajnuse vetëm është në ndërtim dhe nuk e di a ka përfunduar? D.m.th është e njejta. Ndërtimi i QKMF-ve, ktu me siguri është gabim sepse skanë me qenë 2,3 por vetëm një. Edhe ktu kam vërjetje sepse po ndërtohet QMF-të po rindertoet kah 2 tri here, mandej prap të reja dhe mendoj që është para e shpenzuar jo në menyre racionale. Blerja e paisjve mjekësore po ashtu është shqetësim i imi aparati radiologjik, kur e kemi që në shërbimin primar janë dy aparate radiologjike, ky i fundit që është para një viti funksionon shumë mirë, cila është arsya që duhet me ble edhe një? Nërsa sa i përket ortopanit e dim si ka funksionu sepse ketë e kanë bërë të ditë mediat dhe besoj që edhe tash do funksionj në qasi forme. Ndërsa këto aparat oksigjen formues dhe autokllav janë në rregullë. Meqenëse e permendem radiologjinë, ka mungesë të një radiologu, meqenëse e kemi premtu por nuk është askund, dhe po mendoj që jemi duke investu shumë në ndërtime në aparte, por faktori njëri është duke u lën

mbasdore! Në ambulancën ku unë punoj, punoj pa një pulës oksimëter që kushton 30 euro, dhe pa një glikomëter që kushton 30 euro dhe nganjehere mungon edhe termometri.

**Z.Drin Veselaj:** meqenëse sot e kemi diskutimin e kornizës afatshkurter 2025, mendoj që kështu e emrova dhe mendoj që është emërtimi i saktë i kësaj kornize. Për shkak se kjo lëvizja në mes të viteve e shohim qartë, keqvendosjet aty ku planifikohen me u marrë votat janë zhvendosur në vitin 2025. Ndërsa viti 2026,2027 ty pa ty bo. Unë, këto korniza afatmesem të cilat ky pushtet i sjellë këtu, nuk i marr shumë seriozishtë për shkak se jam tash e sa vjet asambleistë. Dhe nëse hyjmë e i shohim këto korniza ndër vite e shohim që asnjë prej tyre nuk është zbatu, le që nuk janë zbatu kornizat që janë dokumente preleminare, miërpo nuk është zbatu as buxheti të cilet e keni votu vet dhe e keni sjellë vet. Pa dasht me u ndal në detaje sepse këtu detajet nganjehere janë tmeruse, psh gjatë leximit e pash ndërtimin e varrezave, varrezat nuk ndërtohet, mundet me u ndërtu rrethojat e varrezave por jo ndërtimi! Gjithashtu edhe një çështje që e kam potencu disa here, për rrugën “Sejnov Gjore” ka fillu qysh në mandatin e parë si asambleist 2013 dhe tani jemi në vitin 2024, dhe planifikimi është për vitin 2025,2026,2027. E kuptoj që tendeca është në vitin 2025 kur janë zgjedhjet dhe me fillu me ndërtu diçka aty, por është mirë me ju tregu qytetarëve të asaj pjese që mjetet për atë punë nuk egzistojnë. Shqetësuse gjithashtu është shtyrja e 12 projekteve, dhe anulimi i dy projekteve në tërësi. Për fund më shqetësuesja për mua është se këtu hala diskutohet ndërtimi i kanaleve në Asllanqeshme ku tani bëhet 1 vjet nga vërshimet ku ka pas edhe humbje jete të njerzve. Pas verishmeve këtu ka pas fjalë të forta që ata njerzë kanë me u kompenzu për dëmet e tyre, mirëpo në ende nuk e dijmë qoftë edhe familja që ka pas viktime a është ndihmu apo ku jeton ajo familje, a ka pas ndonjë përkrahje nga komuna? Sepse nuk po flasim për të tjerët të cilet kanë pas dëme të jashtëzakonshme. Dhe hala më heq që edhe pas një viti ajo lagje rrezikohet nga vërshimet, sepse kanali që është ndërtu uji nuk deperton në kanal, por del jashta kanalit, nuk po kuptoj se mos është bërë ndonjë lidhje e gabuar apo çka është në pyetje, sepse kjo mund të na sjellë pasoja të reja dhe nuk kemi asnjë arësim të vetëm për atë gjendje. Andaj, ndërtimi i lagjes asllanqeshme për vitin 2026 është ndërtim i vonuar sepse ajo duhet me qenë prioritet i qeverisjes lokale që me u realizu sa më shpejtë.

**Znj.Hidajete Nikçi:** nuk po di a mundem të ngrisë ndonjë qeshtje edhe pse jetoj në Lugun e Baranit fsh.Vranoc, por si do që të jetë po e parashtojë këtë qeshtje. Fjala është për ndërtimin e kanalit të ujitjes për regjionin e Lugut të Baranit, Trestenikut, Leshanit, Potgurit dhe Fushës së Pejës. Unë, dhe ma heret në kuvend e kam ngrit këtë qeshtje kam kërku që të jet edhe fsh. Vranoc i përfshirë. Dhe tash e kam një pyetje se a është i përfshirë edhe fsh.Vranoc? Po ashtu edhe një pyetje sqarim ndërtimi i shkollës tek stacioni i autobusave për vitin 2027? Më intereson me dit se cila do të jetë kjo shkollë që do të ndërtohet këtu.

**Z.Labinot Panxha:** pas këtij sqarim une e i kam bo do kërkesa në emer të Aleancës në KPF dhe e mora fjalën me kerku prej juve, që ato kërkesa tona të përfshihen në kornizën afatmesem buxhetore. Sepse në dëxhimet buxhetore nuk kemi marrë pjesë për arsye se informimi nuk po shkon përtej kryetarëve të nëndegjeve të LDK-së, veq me shku pa me tej kryetarve sigurisht që

edhe sikush kish me mar pjesë në diskutim publik, dhe kisha pas mundësi me diskutu për çështje të ndryshme!

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** lajmërimi bëhet në faqe zyrtare të komunes, dhe në grupe ku jeni të gjithë të njoftuar për diskutime publike.

**Kryetari Gazmend Muhaxheri:** së pari më duhet me përgëzuar drejtoreshen e financave dhe zyrtaren kryesore, që për një afat të shkurt kanë arritë me bo Draft-KAB-in e 2025-2027 që është bërë një punë e madhe. Po e shoh që njerëzit po kanë qejf me diskutu se është krye kjo punë e nuk është krye kjo punë, po kush do që është zot shtëpije e din sa pare i ka në gjep dhe nëse ja kanë marrë gjysën e atyre pareve nuk mundet me ju ble krejt fëmijëve bicikleta, nuk mundet rroba e qanta të njëjtë diçka duhet me hek! Janë 6 milionë euro të vitit të kaluar dhe në realitet janë 4 milionë investime kapitale që na janë marrë përse kanë qenë projekte të kontraktuara një pjesë e madhe e tyre. Ketë vjet kemi mbri 5 milionë euro dhe në këto rrethana kaq të vështira, prap se prap kemi arritë me bo një planifikim të mirë. Nuk është krejt e vullosur dhe e qitur miërpo për vitin 2025 është planifiku mirë, e 2026 e 2027 mbetet me punu. Diskutimi për KAB më heret nuk e kemi bërë, tash e bëjmë me qytetarët me ju tregu sa pare i kemi, sa janë prej atyre borgjeve dhe çka mundem me bo me qet buxhet. Në si komunë nuk kemi planifiku për zgjedhje të 2025-es sepse projektet e zgjedhjeve i kemi krye vitin e kaluar, dhe çka vjen në rend me u vlerësu prej qytetarëve na projektet i kemi krye. Palestra “Partizani” është hequr sepse mendohet që ka me bo qeveria, nëse nuk e krye qeveria na e shtijmë prap në kornizë afatmesme tjetren dhe e planifikojmë në vitin 2026 ose 2027. Po ashtu edhe qerdhen në Zahaq e kemi parapa në vitin 2027, nëse qeveria nuk na krye këto qerdhet në 2025-en. Edhe trotuarin prej patrialkanes deri te tunelli e kemi pas me ministri mirëpo e kanë hek prej buxhetit, dmth projekti është i bom prej komunes mirëpo buxheti është hek. Ndërsa në Kryshec, Llozhan nuk mundem me u qit projektet që i kemi nis, sallën e sportit në shkollën “Skenderbe” dhe “Migjeni” në Glllogjan, nuk po mundem me i krye, po shtyhen këto projekte për 1 vjet dhe nuk mundem me planifiku projekte të reja sepse buxheti po bartet prej vitit në vit. Sa i perket sheshit është prej ures zallit e deri te Hajdaragut, mandej vendi kur vjen ura e re duhet me rregullu sheshin diku në vitin 2025 me fillu dhe 2026 me perfundu nëse kemi fat me operatorët që e kryjnë punen. Ujësjellësin e Lugut të Baranit nuk e kemi qit në buxhet, sepse duhet me perfundu sivjet dhe ish dasht uji me qenë i lshum dhe kjo punë me përfundu. Shkolla “Gjimnazi” fillon mu ndërte ketë vjet, dhe besoj që nëse shkojnë punët në rrethana të mira operatori i ri e pren ni” kurban” dhe mandej vitin tjetër mbetet me nda buxhet me me finalizu. Për penden në Vranoc 400 mijë euro investim e kemi bo penden dhe tash punon kanali për me dërgu ujin në fshat. Edhe për rrugën Sejov Gjore është dal tenderi dhe besoj që sivjet kryhet një pjesë e rruges, rruga është 16km dhe 9 km e para kryhen për dy vjet dhe mandej edhe 9 km tjera dhe si premtim kjo rrugë do të bëhet.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro, 12 votë kundër ( votimi me ngritje dore), miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

**5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** në takim KPF drejtori ka qenë prezent dhe ka jep shpjegime rreth ketij shfuqizimi të vendimit.

**Kryetari Gazmend Muhaxheri:** kur është mendu që është punu një projekt për fsh. Raushiq, atëhere ka qenë i gjetum kur jemi ardh në pushtet dhe nuk ka pas impijant ku ka mu derdh ai kanalizim, dhe e kemi marr një vendim me asamble me shpronësu një pronë të një qytetarit aty dhe me bo komplet grumbullimin e ujërave të zeza. Me kohë e kemi pa që nuk po mundet mu bo kjo punë me u grumbulluj krejt dhe tash e kemi bo një projekt të ri që komplet grumbullimin e kanalizimit fshatrave Raushiq, Loxhë, një pjesë të Grabovcit që është në pjesen e sipërme të dardanisë 3 me i qu në impiantin në Gorozhdevcë.

**Z.Berat Ganiqi:** edhe në KPF kemi diskutu për këtë pikë, por edhe ktu po e bëj një pyetje sqarim sepse nuk e kam të qartë. Pronari ka shku në gjykatë dhe atje u tha që është rrit vlera dyfishë, mirëpo pronari është në procedurë gjygjësore nese ai e fiton landen, a jeni të sigurt që komuna nuk ka me u detyru me i pagu diçka ? sespe ju po hekni dorë prej shpronësimit por kur vjen një vendim i gjykates qysh doni me hek dorë, a jeni marr vesh me gjygjëtarin e çështjes a keni bo kërkesë a ka me pas pasoja komuna në buxhet? Se qeshtu si për qështjen e arsimitarëve sepse kur e fiton të drejten atëhere nuk mundesh me ia mohu, ku me dit kush me kon as vet kryeministri as president i shefit, nuk mundet me anuluj një vendim të gjykates kur vjen i formes së prerë. A jeni konsulltu?

**Kryetari Gazmend Muhaxheri:** nuk është larg mendve me mujt me marr vendim gjykatësi, por gjykatësi mundet me mar vendim vetëm për lartësin e kompenzimit. Nëse unë nuk du me ta pagu kompenzimin dhe nëse nuk dua ta marr pronen do të thotë që unë kam hekur dorë me ta marr pronen, dhe prona mbet e jotja. As nuk kam hyr në posedim në tokë tënde dhe ai mundet me thonë paguje dhe mundet me nxirr vleren sespe në gjykatë është vendimi për vleren e prones që e ka kërku pronari. E kemi avokaten qe e mbron komunen, i kemi tregu që kjo pronë spo na vyn kurgjo ja kemi shpjegu, ndërsa në gjykatë është vendimi për lartësimin e pageses, nuk mundet me marr ai vendim shpronësoja me zor për ate nuk ish dashur me mar, por nëse e mer ate vendim e nuk kemi qare pa e pagu vendimin e gjygit dhe ja pagujmë pronen qytetarit dhe merem me diçka tjetër.

**Z.Labinot Panxha:** është interesant me dit edhe qytetarët se nuk po e shpjegon në mënyrë të qartë. Ju po e shpallni në interes publik një pronë të një përsone fizikë, para 4 vite kam dëgju që është i LDK-së, edhe tash je në konest në gjykatë, ju vet e permendet që nuk po më vyn kurgjo prona e tij se ka lyp shtrejtë shumë. Pse më së pari e keni shpallë në intgeres publik? E dyta ja keni uzupu atë pronë që 4-5 vjet, ai nuk ka mujt as me shit e as me shfrytëzu se ka thon ndoshtga e jmer komuna e mer pronen e vlerëson qysh une dua! A mos është ndonjë marrveshje mes juve

që në fund me ju padit ai për qfare kompenzimi të humbur? Tani po vjen ktu dhe po thush qe po vin po mi mer paret gjykata. Gjykata nuk është vend i qudive por vepron në bazë të provave që ju ja qitni perpara se gjygjëtari nuk ta vlerson pronen, por eksperti financiar e vlerson pronen. Ekspertin financiar e keni pas një ma heret, mandej e keni mar njo tjetet, njeher po thua se ja kom vlerson pronen se ajo pronë më ka vyft pastaj kur e ka vlerson ky tjetri ekspert po thush qe tash nuk më vyn prona. Më mirë me thonë është vlerson tjetet se sa me thonë nuk më vyn prona jote sespe po del kundërthënës me atë se qka po deklarom ktu.Prandaj duhet me pas kujdes me planifikimet që i bëni , sespe sikur të ish një planifikim i mirë i asaj prone që e keni mar vendim em shpron%su nuk ishim ardh deri në këtë situatë, ndoshta ju kam keqkuptu por kjo është ajo qe po e mendoj!

**Kryetari Gazmend Muhaxheri:** unë jam përgjegjës se qka flas e jo qka ju kuptoni unë ktu nuk jam përgjegjës. Projekti është i Aleances, dhe këtë projekt mandej unë e kam zbatu ky projekt është i qeverisë juaj dhe mandej është bërë ky kanalizim. Për këtë punë është bërë ai shpronësim atherë, por tash po shihet që nuk mundet mu përdor ajo tokë. Ai padit sepse nuk ka qenë i kënaqur me gjygj, sepse të kish qenë i kënaqur me vendim të vlerësuesve, dhe vlersonimin se bën komuna por e bën Ministria e Financave. Pronari e ka të drejten me u anku në vlersonim, por edhe unë e kam të drejten mos me mar nese me duket shtrejtë.

**Z.Berat Ganiqi:** nese kryetar vi ta bllokoi pronen 5 vjet dhe ta shpalli në interes publik, nese ai ka dasht me shit nuk ka mujt, nese ka dasht me ndërte nuk ka mujt, e ka një fitim të humbur. Nuk mundesh me thonë që dën nuk ju bo atj dhe spo du me ta marr! Në këtë kontest gjygjësor atij një dëm j'u ka bo, sespe ju ka blloku prona. Sepse kur i shpallet në interes publik nuk mundet me ndërte e as me shitë, këtë jam duke e kërku se spo paragjykoj kurgjo vetem në mënyren ligjore atij njëfar dëmi ju ka bo!

**Z.Labinot Panxha:** ky projekt është në vitin 2019 dhe Aleanca nuk ka qenë në pushtet por keni qenë ju!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro,5 votë kundër, dhe 7 votë të përmbajtur,( votim me ngritje dore) miratohet shfuqizimi i Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.

## **6.Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** është një raport që është punuar nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik për periudhen një vjeçare, këtë raport e kemi shqyrtuar edhe në takimin e KPF-së.

**Z. Berat Ganiqi:** Në raportin për zhvillim ekonomik dhe turizem në komunën e Pejës, me ka rënë në sy qe statistikat janë marrë prej Agjesionit Statistikor të Kosovës, në rregull është që janë marrë, mirë po mendoj që komuna duhet ta bëjë një digjitalizim qe i mban statistikat vetë dhe e



din sa turista hynë saktë, mundemi për këtë me u sherby edhe te të dhanat nga të hyrat kufitare që kanë ndodhë në kullë ose tek kufinjët përrrethë. Për me ditë një turizem real se sa te huaj po vinjë, duhet me mbajtë shenime edhe për hotelëritë, shtëpitë që po lëshohen me qera, nuk po them me i tatimu njëherë, sepse ne jemi në zhvillim të turizmit për me mujt me bo një statistikë digjitale të komunës që më pasë të qartë një pasqyrë se sa po rritet numri.

**Z. Islam Husaj:** Unë e kam lexuar këtë raportin, dua të ndalem tek problemet që i keni paraqitur në fund, një ndër to është strategjia për zhvillim ekonomik. Pse nuk kemi strategji dhe kend po e pritni që duhet ta bejë atë strategji, e dyta shumë jeni ankuar për humbjen e stafit, nëse nuk keni puntorë, unë ja'u gjej vetëm pranoni ju edhe atë të kualifikum e eksperta, do të thotë nuk duhet me qenë mungesa e stafit problem sepse kemi njerëz të cilët munden me qenë aty, por duhet me shiku proceduren e pranimit të atyre puntorëve.

### **7.Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.**

**Nënkryetari z. Fatmir Asllani:** Sipas planë programit i kemi mbajtur gjithësej 3 takime në gjashtë mujorin e parë, në fakt rapsorti ka ardhur pak me vonesë për takimin e tret, sepse është mbajtur me datë 20 të ketij muji dhe e kemi përmbyllë sipas planë programit. Komandanti I Policisë ka qenë prezent në të gjitha takimet edhe kryetari i komunës, drejtori i arsimit, janë trajtu të gjitha temat, janë marrë disa konkluzione dhe gjithçka ka shkuar sipas planit. E keqja e kësaj punë është që janë zbehur takimet në KKSB, për shkakë të pagesave që nuk kemi mundur me i realizu ne vitin 2023 e as në vitin 2024. Tani jemi në diskutim edhe Ministriët e linjës edhe jemi duke pritur qe gjatë muajit Qershore të marrim një pergjigjie për pagesat e KKSB-së. Kjo është në të gjitha komunat për shkakë të ligjit që është në fuqi, nuk i ka paraparë ti paguaj, njejtë janë edhe këto që i permendi z. Islami arsya është që nuk janë të përfshira në ligjë dhe vetë Ministritë janë duke gjetur një linjë të ligjit për ti përfshirë. Eshtë dilema a me i përfshi në pjesën e asambles, a ka me mbet në drejtorin e financave, mirëpo buxheti normal qe duhet me u nda edhe me korniza për shkakë që të mos kem probleme tutje në realizimin e pagesave. Po shpresojmë të paktën deri në muajin Gusht kemi me marrë një pergjigjie dhe ne muajin Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të bëhet kompenzimi në menyre retroaktive edhe për vitin 2023 dhe për vitin 2024.

**Z. Berat Ganiqi:** shqetësuese për komunën e Pejës është rritja e dhunës në familje kohet e fundit, nuk e di sa është duke u trajtu kjo teme në KKSB!. Meqenësë Peja, në bazë të të dhënave ditore që po pranohen, është pothuajse gati çdo ditë duke pasur dhunë në familje. Andaj nuk e di këto diskutime a janë bërë në këtë këshillë, ndoshta edhe janë berë, por me sa e kam pa ka qenë ishkurte procesverbalin. Poashtu çka kisha propozu, e kam dergu edhe në email tek kryetari dhe tek komandati policisë së komunikacionit në Pejë, është me bë një zgjidhje gjatë sezonit veror tek rruga QKMF-së, këtë po e jap si një arsyetim për shkakë që gjatë sezonit veror ka bashkëatdhetarë shumë. Nga ora 19:00 kur fillon kujdestaria ajo rrugë fillon dhe bllokohet nga të rinjtë me vetura.

**8.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:**

Nuk ka pasur.

**9.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.**

**Z. Rajan Arapi:** nënkryetari tha se është zbehur aktiviteti i KKSB-së për shkakë të pagesës që ndoshta do te duhej të merren antarët e këtij keshilli apo personat qe janë përgjegjës. Është për keqë ardhje për shkakë të një pagese, që po supozoj se është pagesë simbolike dikush ta zbeh aktivitetin e një keshilli, sepse mendoj qe ai qe e mer përgjegjsinë me qënë pjesë e këtij keshilli nuk e mer për shkakë të pagesës, por e mer për shkakë të aktivitetit dhe rëndesis qe e ka ky kshill. Andaj është mirë që te mos lejohen personat përgjegjes, ata qe janë emru në këtë kshillë ta zbehin aktivitetin për shkakë të një pagesë të tillë, së paku do të ishte mirë të potencohet këta njerëz që nuk janë të gatshëm me dhenë kontributin e tyre në këtë kshillë, duke e ditur rëndësin qe e ka keshilli në fjalë. Andaj është mirë të miren masa, deri sa ligji nuk po lejon, mos te lejohet që të zbehet aktiviteti.

**Z. Islam Husaj:** ky fjalimi i fundit i z.Rajanit më ngacmoj pak, nuk është çështje e një pagesë por është çështje e një rregullit, nje rregullative që është parapa pagesa e atyre njerëzve. E dyta ne jemi duke degradu për çdo ditë e me tutje, nuk paguhen komitetet, nuk paguhen komisonet, nuk paguhet keshilli për siguri, pse nuk paguhen, nuk ka Kosova parë për ti berë pagesat e këtyre njerëzve. Ne vitet paraprake është bë pagesa e tyre, tash nuk po bën, ka kaluar koha e vullnetarizmit, nuk jemi ne vitet 89-2000, nuk është vlera e asnjë antari të një trupi punës nese ti nuk e respekton punën e tijë, ai duhet një ditë me humb, pse me dal ai me i kry ato punë? Për patriotizem? U kry patriotizmi, tani nuk ka kengë folklorike, tani duhet me punu dhe për punën duhet me u kompenzu.

**Z. Skender Kandic:** te nderuar antarë te Kuvendit dhe bashkëpunor te mij, në mbledhjen e fundit jemi dakorduar që të respektojmë mbledhjen dhe të jemi prezent deri në fund dhe besojë që ky është një sinjal shumë i mirë. Kryetari është prezent se bashku me ekzekutivin dhe antrët e tjerë, nuk jam as pozitiv as opozitiv por sot deshiroj të parashtrojë një pyetje për interes të qytetareve, rregullorja qe e rregullon punën tanë por i len disa çështje pa i rregulluar por këto çështje janë shumë me rëndësi. Kam dy pyetje qe dua ti parashtrojë, e para qe dua ta cekim është se qarshia e qytetit tonë është shumë e ozurpuar nga ana e bizneseve të ndryshme, janë disa zinxhira dhe shtylla të cilat janë të vendosura aty ku nuk duhen te jenë, janë edhe disa tavolina te kafiqave dhe të gjithë ju e dini se për çka po flasë. Unë propozojë qe drejtoria e cila është kompetente për këtë punë te gjejë një zgjidhje të qendrueshmë, jo diçka me afat të shkurtër por një zgjidhje për një afat me të gjatë. Askush nuk ka të drejtë te ozorpojë pronën shtetore për të bërë një parking për vetë, gjithashtu nuk mund të vendosën tavolina tek zebrat ku duhen te kalojnë qytetarët. E dyta me kanë lutur njerëz qe punojnë në qarshin e gjatë, që të caktohet një hapsirë ku ata munden ti lejnë biçikletat, trotinetat dhe mjetet tjera me të cilat ata shkojnë në punë.

**Z. Rajan Arapi:** une e kam derguar një pyetje në kerkesë me shkrim e cila ka të bejë me pastrimi e rrugeve pas vërshimeve të fundit që kishim heren e fundit. E dim që prap kanë dalë ujrat e zeza, prap qarshia dhe qendra është vërshu, është mirë të meren masa të pastrohen rrugët sepse koha e nxehtë, era që po vjen sidomos në pjesët e shtepisë së mallrave deri tek qarshia e gjatë.

**Z. Feriz Gashi:** unë e kam një pyetje për drejtorin e shëndetsisë, në këto temperatura kaq të larta, në qendren shëndetsore në Vitomeric nuk ka klimë, jo që jau keni lehtësu punën por jau keni vështiresu, as në dhomë të mjekut nuk ka klimë as në koridor nuk ka, mandej në dhomë të mjekut nuk ka as mjete higjienike.

**Z. Drin Veselaj:** si shqetësim deshta me ngritë punën e premjeve të asfalteve për mu lidhë neper kanalizime dhe ujësjiellës, ndoshta kjo është punë e përbashket e disa drejtorive mirëpo më të vërtet është shqetësuse, për shkak se kemi raste kur ka pasur edhe aksidente në pjesë të ndryshme të rrugës që është pre rruga dhe ka mbet ashtu. Gjithashtu është shqetësuse edhe kanali në Fidanishte që ka shku me shumë probleme dhe punë të ngadalshme, tani po besoj që është afër të paktën rrugën me mbyllë aty ku lidhet të furra që është lidhë me pjesën e Xhemajl Kades me asfaltu atë rrugë, për shkak së dje me së largu kam kaluar në atë rrugë dhe është jashtëzakonishtë e pa kalushme.

**Z. Labinot Panxha:** unë e kam një pyetje për kryetarin, pasë vërshimeve a ke dalë me i vizitu rajonet, konkretisht Lugun e Baranit se sa kanë qenë damet pasë vërshimeve në ato pjesë. Mu me kanë dergu foto disa banor të fshatit Kryshec dhe me kanë njoftuar se mbi 50 hektarë misër dhe kunguj janë demtuar. Gjithashtu për një kohë deri dje rruga Kryshec - Breliq e pa kalushme nga lloqi, pse askush nuk ka shku me i vizitu, a ka me shku dikush ta bëj regjistrimin e këtyre dëmeve dhe mi kompenzu.

**Z. Eleonora Bala:** kam një pyetje për drejtorin e shëndetsisë, janë deshmitarët që në qendren tonë kur puntorët dalin në pension disa prej tyre dalin pa asnjë mirënjohje, dhurat apo të paktën një fjalim dhe disa të tjerë ata të cilët janë të ndegjushëm për këtë drejtorat, ju festohet pensionimi në formën më të mirë të mundshme, pyetja ime është pse po ndodhë kjo. Së fundi Dr. Xhevdet Ademaj doli në pensionim para dy ose tri viteve dhe asnjë aktivitet nuk u nderrmur për pensionimin e tij, i cili i shërbej shërbimit primar gati 40 vite, pse po ndodhë kjo?

**Z. Nezir Jahmurataj:** po e fillojë me një pyetje nga këto vërshimet e fundit, kryetar gjatë verës kur po ka temperatura të larta pa shi, a është e mundur drejtorat me i vizitu kanalet kryesore me i pastru vendet ende pa fillu, se tash në po e dim po na lajmrojnë kur po bie shi. Edhe atë ditë Peja për pak ka qenë e vërshume. Por një vëretje e kanë pasur qytetarët, nëpër kanalet kryesore ku shprazet ujët ka të vendosur gypa të metalit ku janë kabllot elektrike, ato po ndikojnë shumë së kur po hudhin diçka në kanal po ndalet dhe po vërshojnë dhe tjetra kishi planifiku me ndërto diçka në parkun e qytetit në Karragaq, është mirë wc publike me ndërto, sepse aty dalin të moshura, të rinjë e sportista. Aty ka edhe qen endacak shumë, njëkohësishtë edhe për qent endacak e dua një pergjigjie, a është gati me u punu, sepse qytetarët janë të rrezikim. Po ashtu në

parkun e qytetit duhet me vendos kontiniera për mbëturina, sepse aty i hudhin rrugëve dhe trotuareve.

**Z. Naim Bytyqi:** sot deshta me ngritë një çeshtje, kjo temë është diskutu edhe me herët nga koleget tjerë asambleist, ka të bejë me lëvizjen e automjeteve zyrtare të cilat i përdorin zyrtaret komunal. Mua me intereson sa nga ato automjete janë të nevojshme të lëvizin, do të thotë me shku vajtje ardhje në shtëpi, se për punët në qytet ndoshta i kanë të domosdoshme unë nuk po leshohem tek ato. Mirë po unë e kam berë një llogaritje të thjeshtë, drejtori nese banon 20 km larg deri tek ai i cilit banon 10 km lerg qyteti, do të thotë vatje ardhje goma edhe servise nese i pjestojmë në muj 130 euro, ai i ka benefit nga shfrytëzimi i këtij automjeti. Do të thotë ky drejtor e ka 110 -130 euro pagen me te madhe se sa ai zyrtar tjetër që nuk i përdor automjetet zyrtare. A është gjetur forma me ju ngrit pagat në këtë formë, apo është me të vërtet e domosdoshme me u shfrytezu automjetet zyrtare në këtë formë.

**Z. Islam Husaj:** në seancen e kaluar j'a kam bërë një pyetje drejtoreshës, kur kanë me i mbajtë takimet Azem Shkreli, me është thenë së jemi në përpjekje të jashtëzakonshme për me ngritë kualitetin dhe cilsinë e përfomancës. Deshta me pytë a ka arritë diçka me punu në këtë drejtim dhe kur do të mbahen ato, qe tri vite ende nuk janë mbajtur, nuk e di ku është problemi dhe kjo është hera e fundit qe pysë, sepse qe tri vite u bera monoton.

**Znj.Xhenet Syka Kelmendi:** kur do që të mbahen dr.Islam, ke me qenë mysafiri im i parë me ftesë.

**Z. Berat Ganiqi:** në lidhje me vërshimet e fundit në qytetin e Pejës, u pa aty ku është punu është tejkalu, në asllan qeshme pat një tekalim nuk patë vershime, në fidanishtë është punu ai kanali u tejkalu, ndersa në disa pjesë tjera ku nuk është punu, ka pasur rrëzikushmeri. Ne lagjen time është e pamundur mos me ndodh nese një gyp aty që kam berë disa herë kerkesë mu pastru nese nuk pastrohet, ai është i bllokum, dihet pse është blloku, mi dhanë qasje një ndertesë qe është ndertu që sa kohë dhe është blloku gypi.Çeshtja tjetër është ozurpimi dhe mbulimi i kanalizimeve. Jemi dy familje në lagje që nuk e kemi mbulu kanalizimin. A të mbulojmë edhe na që mos të na hyn uji apo si është problemi. Nesë është ajo zgjidhja ateherë po e mbulojmë edhe ne edhe po e tejkalojmë. Dhe kjo e fundit për larjen e rrugëve, nuk mundet me ndodh larja pa u hek dheu. Për fund kryetarin dua ta pysë edhe sa lisa e ki ndermend mi pre, çka je tu bo me gjelberim?

**Kryetari Gazmend Muhaxheri:** lisi që është pre, 60 lisa janë mbillur mbas, me para private i kam mbillur 12 gështenja te egra. Ai që është pre tek qendra zejtare dhe ky ne korzë e shihni qe është trupi brenda i kalbur. Ne e kemi një qytetare tonën qe ka mbet e dëmtuar perjet, pse ni lisë në Prishtinë e ka mbyt një njeri dhe e ka demtu ketë. Këta lisa janë prerë për qetë punë. Këto që janë të korza një prej krejt atyre ëdhtë hek, sepse nuk e ka vendin aty, kur e rregullojmë një shesh per 100 vitet e ardhëshme duhet me pasë pak durim, sepse kemi me i mbjell pemt edhe me shumë edhe me të medha. Për qent endacak e kemi bë konkursin, kompania qe e ka fitu nuk e ka

nënshkru, e kemi bërë tash konkursin e ri por po kemi ankesa. Ligji nuk e lejon atë që po e kërkojnë qytetarët eliminimin, ligji e kërkon vaksinimin, sterilizimin edhe kthimin pasë tri ditë në rrugë aty ku e ke marre. Tek pyetja e Z. Arjan Arapi për pjesën që ka mbetur tek shtëpia e mallrave pa u rregullu mundohemi me parapa tash me një buxhet të ri në planifikimet që i bëjmë për me rregullu. Për parkinget e kemi një shkresë kryeministrisë, pronat që kanë qenë me interes publik, në qeverinë Haradinaj janë pasë hekë dhe kemi kerku mi hekë 12 deri sa janë shitur 2 nuk janë hekur, mandej janë hekur 10 dhe janë kthyer komunës. Tani qeverisë Kurti i kemi bërë kërkesë, për ti hekur këto prona nga shitja, njëra prej tyre është edhe tregu i bylmetit, kishim mundur aty me zgjidh edhe problemin për parking të bicikletave dhe mjeteve tjera. Për Lugë të Baranit dhe dëmet e bujqësisë, qytetarët i drejtohen drejtorisë bujqësisë, drejtoria e bën një raport ja dergon ministris dhe ministria ku e sheh të arsyshme i kompenzon. Do të thotë komunës nuk i është lenë e drejta për këto kompenzime. Sa i përket vërshimeve njera pjesë e lagjës asllan qeshme ku e kemi punuar kanali ka funksionu si është mas miri, ndërsa kjo pjesa tjetër që nuk është e përfundime na po besojmë që deri ka fundi i gushtit ka me përfundu, na mbetën këto tri shtëpiat ku ka ndodhë ajo tragjedia dhe dy perfundri me një vendim kur të kryhen procedurat e trashigimisë, diçka me ju kompenzu. Nuk mundet krejt por diçka me ju dhënë, do të thotë tri shtëpi me ju jep, tri parcella që i ka komuna në anën e kundërt të rrugës tjetër. Ndërsa kjo rruga për tu asfaltu, është edhe ajo rruga që është pre edhe ajo rruga që shkon drejtë të shkolla, kemi me i rrenu disa ozurpime që janë në atë pjesë.

**Znj. Dafina Draga:** e kam vetëm një kërkesë për komitetin e shëndetësisë; ja kam nisë Dr. Islamit si kryesus por vetëm po e lexojë për hirë të puntorëve shendetësor. Kanë kërkuar tre mjek që nuk po jau permendi emrat, koeficienti i cili duhet të jetë 8.0 për mjekë të përgjithshëm vazhdon të jetë 7.4, ata kanë kërkuar të dinë se çka duhet të ndermarrin për këtë ndryshim. E dyta është të shqyrtohet çështja e pagesave e trajnerëve që ligjerojnë në trajnime që zhvillohen në QKMF në Pejë që përcjellen me plan program të akredituar nga oda e infermiereve. Çështja e tretë është të dielat të paguhen si vikend dhe jo si kujdestari, pra të paguhet 50% dhe jo 20%. Dhe për fund dua të themë se aty brenda në QKMF punon një ekip e cila përballon një numër të madhë të pacientave, dhe arrin të ju pergjigjet me një përkushtimeri të pa përshkrumshme, unë i lavdojë dhe jamë shumë mirënjohëse dhe e kerkojë këtu në kuvend që gjithëmonë në kujdesin primar ky departament të ketë prioritet dhe ti ketë kushtet të cilat i përkrahim ne të gjithë.

**Z. Petrit Loci:** po pergjigjem së pari në pyetjen e asambleistit që e parashtrojë për QMF-në në Vitomericë, po e pohojë që nuk qendrojnë ato që i tha, kemi problem me klimatizim, jo pse nuk ka klimatizim, është klimatizim qendror dhe modern, i gjithë objekti ka infrastrukturën me moderne të kërkuar për institucion shendetësor, por ju që e njihni pak atë regjion e dini që ka probleme me tension të rrymës. Ku një pjesë e regjionit ka tension jashtëzakonishtë të ulët, paisja për të cilën është e instaluar, pra klimatizimi qendror kërkojnë rrymë të qendrushme dhe për këtë nuk aktivizohet. Jemi duke bërë përpjeke me inxhinieret e elektros që të sigurojmë një korrektor të rrymës. Sa i përket materialit shpenzues që pohojë, po e theksojë që është përgjisi e

udhëheqësit të njësis me i kërku kur nuk ka. Tek pytja për penzionimet e stafit, është e vertetë që nuk organizojmë ceremoni apo darka, që nga fillimi i pandemisë, atë kohë e kemi pas ndaluar këtë çështje. Do të organizohet nga fillimi i pandemisë e deri me sot, të gjithë ata që janë pensionuar do të organizohet një ceremoni e veçant. Janë berë të gjitha përgaditjet, nuk behën dallime në baza partiake apo sipas qefit, do të behët një organizim i përgjithshëm, do të nderohen të gjithë ata që kanë kontribuar, qoftë edhe një periudhë e vogel kohore, e lerë me për ata që kanë dhenë kontribut me dekada.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=EAo2BHoXmp0>

Procesmbajtësja,  
znj. Donjeta Morina



KRYESUESI I KUVENDI,  
z. Rexhep Kurtbogaj

